

VENDIMI GJYQTARIT TE VETEM

Ne Tirane, sot, me daten 12. nendor 2003, une, Gjyqtarja e Gjykates se Shkalles se Pare Tirane, pasi shqyrtova kerkesen e dokumentat paraqitur nga zoti Jorgo Papadhropulli, lidhur me regjistrimin si person juridik te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "Radio Ngjallja" Sh.p.k.

k o n s t a t o v a

Kerkuesi eshte administratori i shoqerise "Radio Ngjallja" Sh.p.k., e themeluar nga ortaket Jorgo Papadhropulli dhe Kristaq Bakallbashi, me aktin noterial nr.rep 5939 dhe nr.kol.686 te noteres Drita Pepi Tirane, me qendren legale ne Tirane, ne adresen : Rr.e Kavajes, nr.151. Shoqeria ka per objekt ekskluziv : "transmetim me radio vendore me sinjal tokesor me modulim ne frekuencen per Rrethin e Tiranes dhe Rrethin e Durrresit". Kohezgjatja e shoqerise eshte per nje periudhe te papercaktuar. Kapitali themeltar eshte caktuar ne shumen prej leke 100.000 (njeqindmije), te ndare ne 100 pjese, ne raport me pjeset korresponduese te kapitalit te poseduara nga secili prej ortakeve, respektivisht : 50 perqind dhe Kristaq Bakallbashi 50 perqind. Administratori i pare i shoqerise emerohet Jorgo Papadhropulli, per nje periudhe kohe tre vjecare.

Kerkesa e paraqitur nga i interesuari eshte e drejte dhe si e tille duhet pranuar

per keto aresye


Bazuar ne kerkesat e Ligjit 7638/1992, te Ligjit 7632/1992 dhe te Ligjit 7667/1993

v e n d o s a

Regjistrimin e shoqerise "Radio Ngjallja", si person juridik ne Regjistrin Tregetar, Tirane, e themeluar nga ortaket Jorgo Papadhropulli dhe Kristaq Bakallbashi, me aktin noterial nr.rep 5939 dhe nr.kol.686 te noteres Drita Pepi Tirane, me qendren legale ne Tirane, ne adresen : Rr.e Kavajes, nr.151. Shoqeria ka per objekt ekskluziv : "transmetim me radio vendore me sinjal tokesor me modulim ne frekuencen per Rrethin e Tiranes dhe Rrethin e Durrresit". Kohezgjatja e shoqerise eshte per nje periudhe te papercaktuar. Kapitali themeltar eshte caktuar ne shumen prej leke 100.000 (njeqindmije), te ndare ne 100 pjese, ne raport me pjeset korresponduese te kapitalit te poseduara nga secili prej ortakeve, respektivisht : 50 perqind dhe Kristaq Bakallbashi 50 perqind. Administratori i pare i shoqerise emerohet Jorgo Papadhropulli, per nje periudhe kohe tre vjecare.

Kunder ketij vendimi lejohet ankim ne Gjykatën e Apelit Tirane.

GJYQTARE



Muuties registru em

30529

1. "Radio Lingjälje", sept.
2. La. Kavajis, Nr 151, Tirane
3. Transmissiu radio veshore (ir. Dr)
4. 100.000 lekë.
5. Jozef Papadopoulos 50%; Kristaq Baballballi 10%
6. Adm: J. Papadopoulos
7. për 3 vjet 12 rinovime
8. ATU - 24.
9. Statuti - 57 + 151. dt. 08. 11. 03
10. Tirane, më 12. 11. 03.

N.o: Kartelën e koteres D. Pepi Tirane
Nr 5941 rep. dt. 08. 11. 03

Gjyqtare
D. Lemp
[Signature]



REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
NOTERE DRITA PEPI
Nr.Rep. 5939
Nr.Kol. 686



AKT THEMELIMI I SHOQERISE "RADIO NGJALLJA" Sh.p.k.

Ne Tirane, sot, me daten 08.11.2003, perpara meje noteres Drita Pepi, ketu ne studion time ne Tirane, ne adresen : Bulevardi Zhan D'Ark, perbri Gjykates se Shkalles se Pare Tirane, jane paraqitur personalisht, zoterinjte :

- 1. Jorgo Papadhopulli**, i biri i Gaqos dhe i Merit, lindur ne Tirane, me 28.11.1965, me banim ne Tirane, madhor, me zotesi te plote per te vepruar, identifikuar me Certifikaten e Lindjes, date 23.09.2003, nr.73/46, leshuar nga Zyra e Gjendjes Civile, te Njesise Bashkiake Nr.1, Tirane, dhe
- 2. Kristaq Bakallbashi**, i biri i Zoit dhe i Jolandes, lindur ne Durres, me 31.07.1974, me banim ne Tirane, madhor, me zotesi te plote per te vepruar, identifikuar me Certifikaten e Lindjes, date 15.02.2003, nr.120-27-7, leshuar nga Zyra e Gjendjes Civile, te QR nr.3, Bashkia Durres

te siperpermendurit, mbi identitetin e te cileve, une, noterja jam e sigurte, me kerkojne t'u marr kete akt, me te cilin bazuar ne kerkesat e Ligjit 7638/1992, si dhe te Ligjit 8410/1998, jane dakord te themelojne shoqerine me pergjegjesi te kufizuar, ne kushtet dhe menyren, sa me poshte :

Neni 1

Ndermjet tyre themelohet nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, me emertimin Radio Ngjallja Sh.p.k.

Neni 2 Qendra e shoqerise

Shoqeria do te kete qendren e saj legale ne Tirane, ne adresen : Rr.e Kavajes, nr.151. Shoqeria mund te ngreje edhe qendra te tjera sekondare, filiale, dege, perfaqesi, agjensi dhe zyra perfaqesimi ne rrethe te tjera te vendit apo jashte tij.

Neni 3 Objekti

Shoqeria ka per objekt ekskluziv : " transmetim me radio vendore me sinjal tokesor me modulim ne frekuencen per Rrethin e Tiranes dhe Rrethin e Durresit "

Neni 4 Kohezigjatja

Kohezigjatja e shoqerise eshte per nje periudhe te papercaktuar.

Neni 5 Kapitali themeltar

Kapitali themeltar eshte caktuar ne shumen prej 100.000 (njeqindmije), te ndare ne 100 pjese, me vlere nominale 1.000 leke secila dhe mund te shtohet me vendim te asamblese ne raport me pjeset korresponduese te kapitalit te poseduara nga secili prej ortakeve.

Pjesemarrja e ortakeve ne kapitalin themeltar eshte respektivisht :

1. Jorgo Papadhropulli.....50 perqind ose 50.000 leke
2. Kristaq Bakallbashi.....50 perqind ose 50.000 leke

Neni 6 Organet e shoqerise

Organet e shoqerise jane administratori/et dhe asamblea, detyrat e te cileve parashikohen ne statutin e saj. Administratori i pare i shoqerise emerohet Jorgo Papadhropulli, per nje periudhe kohe tre vjecare, te rinovueshme.

Ngarkohet administratori i shoqerise Jorgo Papadhropulli te beje te gjitha veprimet, anulimet, shtesat, korigjimet dhe permiresimet e domosdoshme dhe te nevojeshme ne aktet, nese do te kerkohet nga organet e gjykates, me rastin e vendimit per regjistrimin, si person juridik ne regjistrin tregetar, si dhe te gjitha praktikat dhe dokumentat e tjere per ekzistencen ligjore te shoqerise.

Neni 7 Legjislacioni

Ne perputhje me legjislacionin ne fuqi, shoqeria eshte person juridik shqiptar dhe veprimtaria e saj do te rregullohet, ne baze te ketij akti themelimi dhe te statutit te saj. Per gjithcka te paparashikuar ne kete akt themelimi dhe statut te shoqerise, do te zbatohet legjislacioni shqiptar.

Neni 8

Te gjitha dispozitat e tjera, qe rregullojne shoqerine, perfshihen ne statutin e shoqerise, qe lexohet paraprakisht nga ana ime noterja; ua jap ate te pranishmeve dhe pasi nenshkruhet akti sebashku me mua noteren, lidhet si pjese perberese e aktit te themelimit.

Ky akt themelimi eshte redaktuar ne gjuhen shqipe, ne gjashte ekzemplare origjinale, me kompiuter, perbehet prej dy (2) faqeve te plota.

Lexuar, aprovuar, nenshkruar

ORTAKET

Jorgo Papadhropulli


Kristaq Bakallbashi

Jorgo Papadhropulli

Kristaq Bakallbashi

Bakallbashi





REPUBLIKA E SHQIPERISE
 DHOMA E NOTERISE TIRANE
 NOTERE DRITA PEPI
 Nr. Rep. 5940
 Nr. Kol. 687



STATUTI I SHOQERISE " RADIO NGJALLJA " Sh.p.k.

Neni 1 Emertimi

Themelohet nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, me emertimin " Radio Ngjallja " Sh.p.k.

Neni 2 Objekti

Shoqeria ka per objekt ekskluziv : " transmetim me radio vendore me sinjal tokesor me modulim ne frekuencen per Rrethin e Tiranes dhe Rrethin e Duresit "

Neni 3 Qendra e shoqerise

Shoqeria do te kete qendren e saj legale ne Tirane, Rr. e Kavajes, nr.151. Shoqeria mund te ngreje edhe qendra te tjera sekondare, filiale, dege, perfaqesi, agjensi dhe zyra perfaqesimi ne rrethe te tjera te vendit apo jashte tij.

Neni 4 Kohezgjatja

Kohezgjatja e shoqerise eshte per nje periudhe te papercaktuar.

Neni 5 Kapitali themeltar

Kapitali themeltar eshte caktuar ne shumen prej leke 100.000 (njeqindmije), te ndare ne 100 pjese, me vlere nominale 1.000 leke secila dhe mund te shtohet me vendim te asamblese ne raport me pjeset korresponduese te kapitalit te poseduara nga secili prej ortakeve.

Pjesemarrja e ortakeve ne kapitalin themeltar eshte respektivisht :

- 3. Jorgo Papadhopulli.....50 perqind ose 50.000 leke
- 4. Kristaq Bakallbashi.....50 perqind ose 50.000 leke

Per derdhjet e kryera paraprakisht nga ortaket ne perpjestim me pjesemarrjen e tyre, nuk aplikohen kamata (interesa) te cfardo lloj ne pergjithesi, pervecse kur asamblea ka vendosur ndryshe.

Neni 6 Transferimi i pjeseve

Pjeset e kapitalit themeltar jane te gjitha nominative, ato jane te gjitha te transferueshme ndermjet te gjalleve dhe me trashegim per shkak te vdekjes.

Ortaket kane te drejten e parablerjes per pjeset e vena ne shitje nga ortaket e tjere te treteve. Pjeset e kapitalit te shitura duhet te vihen ne dispozicion te administratorit duke deklaruar cmimin e ofruar nga te tretet. Ne rast te shume bleresve ndermjet ortakeve qe mbesin, pjeset e shitura do te ndahen proporcionalisht me kontributet qe ata posedojne.

Ortaket, te cilet deshirojne te blejne pjeset e vena ne shitje, por qe nuk jane dakord me cmimin e ofruar kane te drejten per t'i blere me nje cmim te vendosur nga nje ekspert i zgjedhur me marreveshje te perbashket ndermjet ofertuesit dhe bleresit dhe, ne rast se

[Handwritten signatures]

nuk bjene dakord, nga nje ekspert i emeruar nga Kryetari i Gjykates Tirane me kerkese te njerres nga palet; pergjigjia ortakut ofrues per te pranuar oferten e tij dhe kerkesa per te emeruar nje ekspert, duhet te jepet brenda 30 diteve nga kerkesa e tij.
Doreheqja eventuale nga e drejta e parablerjes do t'i komunikohet nga administratori shitesit, i cili dhe mund t'ua shese kuotat te treteve.

ASAMBLEA

Neni 7

Secili ortak ka te drejten e nje vote per cdo pjese qe posedon.

Neni 8

Asamblea e mbledhur rregullisht perfaqeson bashkesine e ortakeve dhe vendimet e saj merren ne konformitet me ligjin, me dispozitat e ketij statuti dhe jane detyruese per te gjithë ortakët, si per ata qe mungojne dhe/ose ata qe jane kunder.

Neni 9 Thirrja e asamblese

Asamblea thirret me leter rekomande, me lajmerim marrje dhe/ose cdo mjet tjetër te komunikuar ortakeve sepaku 15 dite perpara mbledhjes se saj, pikerisht ne vendqendrimet qe rezultojne nga libri i ortakeve. Keta te fundit jane te detyruar te komunikojne me shkrim ndryshimet e vendqendrimeve te tyre brenda 30 diteve nga ndryshimet e bera dhe, ne te kunderten, vendqendrimi zgjidhet prane qendres legale te shoqerise.
Asamblea mund te mblidhet rregullisht edhe ne mungese te zbatimit te nje formaliteti te tille, nese eshte present ose i perfaqesuar i gjithë kapitali i shoqerise.

Neni 10

Thirrjet a asambleve, te cilat mund te mblidhen si prane qendres se shoqerise ashtu edhe ne vende te tjere te treguar ne njoftimin perkates, behen nga administratori dhe duhet te permbajne qarte rendin e dites.

Neni 11

Asamblea eshte e zakoneshme dhe e jashtezakoneshme. Asamblea e zakoneshme duhet te thirret sepaku nje here ne vit, brenda kater muajve nga mbyllja e vitit ushtrimor.
Asamblea e jashtezakoneshme thirret te marre vendimet e saj per kompetence aq here sa administratoret e gjykojne te aresyeshme ose kur parashikohet nga ligji.
Thirrja e asamblese duhet te behet, gjithashtu, pa vonese edhe kur parashikohet nga ligji.

Neni 12 Perfaqesimi ne asamble

Kane te drejte te marrin pjese ne asamble ortakët qe rezultojne te regjistruar ne librin e ortakeve te pakten pesembedhjete dite perpara asaj te fiksuar nga asamblea. Secili ortak mund te perfaqesohet nepermjet prokures se posacme, nga nje ortak ose persona te tjere edhe pse nuk jane te bashkesise se ortakeve.



Neni 13 Drejtimi i asamblese

Per drejtimin e asamblese dhe mbajtjen e process verbalit te mbledhjes emerone nje Kryesues dhe nje sekretar, i cili mund te mos jete ortak. Ne raste te vecanta, asamblea mund te emerroje nje noter per te mbajtur proces verbalin e mbledhjes.

Neni 14 Vendimet e asamblese

Vendimet e asamblese duhet te pasyrohen nga proces verbalet e nenshkruar nga Kryesuesi dhe sekretari dhe, ne fund, nga te gjithë ortakët dhe perfaqesuesit e tyre. Ne proces verbal duhet te hidhen ne menyre te permblodhur, mbi kerkesen e ortakëve, deklarimet e tyre.

Neni 15

Vendimet e asamblese, te marre ne konformitet me ligjin dhe kete statut, jane te detyrueshme per te gjithë ortakët edhe pse jo te pranishem ose qe jane kunder. Kundershtimet eventuale te vendimeve asambleare duhet te paraqiten ne kuptim dhe ne afatet e percaktuara nga ligji dhe, ne mungese, brenda 15 (pesembedhjete) diteve nga marrja e vendimit te motivuar. Asamblea duhet te thirret ne mbledhjen me te afert brenda tridhjete diteve per te dhene nje pergjigjje perfundimtare.

Neni 16 Organi administrativ

Shoqeria drejtohet nga nje administrator i vetem, per nje periudhe tre vjecare, te rinovueshme edhe per nje vit tjeter. Asamblea mund te shkarkoje administratorin dhe mund te emerroje me shume se nje administrator nese e gjykon te aresyeshme.

Ne rast te emerimit te me shume se nje administratori, asamblea percakton edhe pushtetet per secilin prej tyre. *Administratori i pare i shoqerise emerohet Jorgo Papadhollu.*

Neni 17 Pushtetet e administratorit

Administratori ose administratorët jane te veshur me pushtete te administrimit te zakonshem. Organi administrativ nuk mund te kryejë veprime te shitjeve te sendeve te paluejtshem te shoqerise, te jape peng, ose te lejojë vendosjen e ipotekes mbi sendet e paluejtshem te shoqerise pa aprovimin e asamblese se shoqerise, e cila duhet te vendose me unanimitetin e te gjithë ortakëve, ne baze te ligjit apo statutit.

Neni 18

Firma dhe perfaqesimi i shoqerise ne mardhenie me te tretet dhe ne proceset gjyqesore i takojne administratorit.

Administratorit nuk i takon ndonje shperblim per punen qe ben, pervecse kur asamblea ka vendosur ndryshe.

Neni 19

Secili ortak ka te drejte te marre nga administratorët njoftime per zhvillimin e problemeve te biznesit te shoqerise dhe te kontrolloje librat e ortakëve. Ortakët kane te drejte dy here ne vit te kontrollojne administrimin e shoqerise, me shpenzimet e tyre.



BILANCI DHE FITIMET

Neni 20

Viti ushtrimor mbyllet me 31 dhjetor te cdo viti. Administratori ose administratoret duhet te parashikojne qe, brenda afateve dhe ne baze te ligjit, te perpilojne bilancin me te ardhurat dhe humbjet duke i pasqyruar ato ne nje relacion mbi ecurine e drejtimit te shoqerise.

Per nevoja te vecanta te domosdoshme, administratori i paraqet asamblese bilancin dhe asamblea e miraton perpara afatit maksimal prej gjashte muajsh, te percaktuar nga ligji.

Neni 21 Ndarja e fitimeve

Fitimet e marra nga viti ushtrimor, jane ne dispozicion te asamblese.

Neni 22

Dividendet e paterhequr brenda nje pesevjecari, nga dita, ne te cilen jane bere te pagueshem, parashkruhen dhe shkojne ne favor te shoqerise.

PRISHJA E SHOQERISE DHE LIKUJDIMI

Neni 23

Ne rast te prishjes se shoqerise, per cfardolloj shkak, asamblea vendos menytrat e likujdimit, emeron nje ose disa likujdatore, duke percaktuar dhe pushtetet e tyre.

Mosmarreveshjet e lindura eventualisht ndermjet ortakeve dhe organeve te shoqerise do te zgjidhen nga dy arbitra te emeruar, nje nga secila prej paleve; i treti me marreveshje te perbashket e, ne te kunderten, do te caktohet nga gjykata.

Neni 24

Te gjitha mosmarreveshjet e lindura do te zgjidhen nga gjykata kompetente, percaktuar ne baze te ligjit.

Neni 25 Zgjidhja e mosmarreveshjeve

Mosmarreveshjet e lindura ndermjet shoqerise dhe ortakeve, administratoreve dhe likujdatoreve, ne vartesi te rregullave te percaktuara nga ky statut, do te zgjidhen dhe vendosen nga tre arbitra te emeruar, nje nga secila prej paleve, dhe i treti me marreveshje te perbashket dhe, ne te kunderten, nga Kryetari i Gjykates. Kolegji i arbitrave do te funksionojte per ta zgjidhur problemin me pajtim, do te percaktoje edhe masen e shpenzimeve dhe kompetencat qe u perkasin arbitrave.

Neni 26

Persa nuk eshte parashikuar shprehimisht ne kete statut, referimi do t'u behet dispozitave te Kodit Tregetar, te Kodit Civil dhe ligjeve te tjere shqiptare ne fuqi.




Neni 27

Ky statut eshte redaktuar ne gjuhen shqipe e shtypur ne gjashte ekzemplare origjinale ne kompiuter, ne pese faqe te plota, kurse e gjashta (6) arrin deri ketu.


Lexuar, aprovuar, nenshkuar

ORTAKET

Jorgo Papadhopulli



Kristaq Bakallbashi



Bakallbas





REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
NOTËRE DRITA PEPI
Nr.Rep. 5941



VERTETIM

Ne Tirane, sot, me daten 08.11.2003, perpara meje noteres Drita Pepi, ketu ne studion time ne Tirane, ne adresen : Bulevardi Zhan D'Ark, perbri Gjykates se Shkalles se Pare Tirane, eshte paraqitur personalisht, zoti Jorgo Papadhopulli, i biri i Gaqos dhe i Merit, lindur ne Tirane, me 28.11.1965, me banim ne Tirane, madhor, me zotesi te plote per te vepruar, identifikuar me Certifikaten e Lindjes, date 23.09.2003, nr.73/46, leshuar nga Zyra e Gjendjes Civile, te Njesise Bashkiake Nr.1, Tirane. Ai shpjegon se do te depozitoje 100.000 (njeqindmije) leke si vlere te kapitalit themeltar te shoqerise ne formim e siper " Radio Ngjallja " Sh.p.k. Une, noterja lejoj depozitimin dhe vertetoj marrjen e kesaj shume ne dorezim.

Depozituesi
Administratori Jorgo Papadhopulli

Jorgo Papadhopulli
[Signature]

NOTERE



[Signature]

Shoqeria "Radio Ngjallja"
Rr.e Kavajes, nr.151
Tirane

30529



3 B Muzë
10 11 2003
2003

KERKESE

KERKUESI : Jorgo Papadhopulli, i biri i Gaqos dhe i Merit, lindur ne Tirane, me 28.11.1965, me banim ne Tirane, madhor, me zotesi te plote per te vepruar, identifikuar me Certifikaten e Lindjes, date 23.09.2003, nr.73/46, leshuar nga Zyra e Gjendjes Civile, te Njesise Bashkiake Nr.1, Tirane, - *ketu me cilesine e Administratorit te shoqerise "Radio Ngjallja"*.

OBJEKTI : Kerkohet regjistrimi i shoqerise "Radio Ngjallja", si person juridik ne Regjistrin Tregetar, Tirane.

Baza Ligjore : Ligjet : 7638/1992, 7632/1992 dhe 7667/1993.

Per kompetence :

GJYKATES SE SHKALLES SE PARE
TIRANE

Une, Jorgo Papadhopulli, me cilesine e Administratorit te Shoqerise "Radio Ngjallja" Sh.p.k., parashtroj perpara kesaj te Nderuare Gjykate kerkesen time, sa me poshte :

Duke respektuar kerkesat e Ligjit 8410/1998 " per radion dhe televizionin publik dhe privat ", me te gjithë ndryshimet e mevonshem, dhe posacerisht Ligjin 8794/2001, ku sipas nenit 7, paragrafi 6 te te cilit, urdherohet qe licensat u jepen subjekteve te regjistruara me objekt ekskluziv vetem ushtrimin e veprimtarise per transmetim televiziv ose radio vendore, ortaket Jorgo Papadhopulli dhe Kristaq Bakallbashi, me aktin noterial nr. regj. 5939 dhe nr.kol.686 te noteres Drita Pepi Tirane, kane themeluar ne Tirane, shoqerine me pergjegjesi te kufizuar " Radio Ngjallja " Sh.p.k., me qendren legale ne Tirane, ne adresen : Rr.e Kavajes, nr.151. Shoqeria ka per objekt ekskluziv : " transmetim me radio vendore me sinjal tokesor me modulim ne frekuencen per Rrethin e Tiranës dhe Rrethin e Durrësit ". Kohezgjatja e shoqerise eshte per nje periudhe te papercaktuar. Kapitali themeltar eshte caktuar ne shumen prej 100.000 (njeqindmije), te ndare ne 100 pjese, ne raport me pjeset korresponduese te kapitalit te poseduara nga secili prej ortakeve respektivisht : Jorgo Papadhopulli 50 perqind dhe Kristaq Bakallbashi 50 perqind. Administratori i pare i shoqerise emerohet Jorgo Papadhopulli, per nje periudhe kohe tre vjecare, te rinovueshme.

Per arsyyet qe parashtroam me lart, kerkojme nga ajo e Nderuara Gjykate, qe ne referim te dispozitave ligjore te cituara ne objektin e ketij akti, te vendose per : regjistrimin e shoqerise " Radio Ngjallja ", si person juridik ne Regjistrin Tregetar, Tirane.

Me respekt

Administratori : Jorgo Papadhopulli

Bi...
12/11/03

Jorgo Papadhopulli

